



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:057879

Datë: 14.10.2022

Numri i dokumentit: 03528234

PN.S.nr.41/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - DEPARTAMENTI SPECIAL, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Afërdita Bytyçi – kryetare e kolegjit, Kreshnik Radoniqi dhe Bashkim Hyseni – anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bajram Rexhahmetaj, në çështjen penale ndaj të pandehurve P.L., N.SH. dhe E.B., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së; të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.40/2019, të datës 04.02.2022, si dhe kundër të pandehurit B.T., për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve P.L., avokat Musa Damati, N.SH., avokat Driton Musliu, E.B., avokat Afrim Salihu dhe B.T., avokat Urim Vokshi, të ushtruara kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Departamenti Special në Prishtinë PS.nr.4/22 të datës 24.06.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 22.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të pandehurve P.L., avokat Musa Damati, N.SH., avokat Driton Musliu, E.B., avokat Afrim Salihu dhe B.T., avokat Urim Vokshi, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore -Departamenti Special në Prishtinë, PS.nr.4/22 të datës 24.06.2022, **VERTËTOHET**.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, me aktakuzën PPS.nr.40/2019, të datës 04.02.2022, ka akuzuar të pandehurit: P.L., N.SH. dhe E.B. për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa të pandehurin B.T. me aktakuzën PPS.nr.40/2019, të datës 18.02.2022 ka akuzuar për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, duke vepruar sipas kërkesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, më datë 03.03.2022 ka marr Aktvendim me të cilin ka bashkuar procedurën penale të lëndës PS.nr.4/2022, në të cilën të pandehur janë P.L., N.SH. dhe E.B., të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.40/2019, të datës 04.02.2022, me lëndën PS.nr.10/2022, në të cilën në cilësi të pandehurit është i pandehuri B.T., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.40/2018, të datës 18.02.2022, ashtu që kundër të pandehurve do të udhëhiqet një procedurë e përbashkët penale me numër të lëndës PS.nr.4/2022.

Gjykata duke vepruar sipas aktakuzave të lartshënuar në këtë çështje penale, ka mbajtur shqyrtim fillestar me datë 04.05.2022, në të cilin të pandehurit P.L., N.SH., E.B. dhe B.T., në prani të mbrojtësve të tyre deklaruan se nuk e pranojnë fajësinë për veprat penale me të cilat i ngarkon aktakuza. Andaj, gjykata të njëjtit i udhëzoi për të drejtën e tyre që brenda afatit të përcaktuar prej 30 ditësh mund të parashetrojnë Kërkesë për Hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim ndaj provave.

Në seancën e shqyrtimit të dytë me datë 17.06.2022, mbrojtësi i të pandehurit P.L., av.Musa Damati, mbrojtësi i të pandehurit N.SH., av.Driton Musliu, mbrojtësi i të pandehurit E.B., av.Afrim Salihu, dhe mbrojtësi i të pandehurit B.T., av.Urim Vokshi, kanë elaboru kërkesat për kundërshtimet e provave dhe hudhja e aktakuzës më pas është prezantuar përgjigjja e prokurorit të PSRK-së rreth kërkesës së mbrojtësve, ku gjykata për pretendimet e palëve në procedurë ka vendos jashtë seance me vendim.

Gjykata, lidhur me kërkesat nga mbrojtësit e të pandehurve, e ka njoftuar Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës e cila në përgjigje ndaj kërkesave për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtime të provave ka theksuar se kërkesat e mbrojtësve janë të pabazuara dhe si të tilla nuk qëndrojnë, andaj i propozoj gjykatës që kundërshtimet e avokateve për hedhjen poshtë të kësaj aktakuze të refuzohen si të pa bazuara.

Gjykata Themelore Departamenti Special në Prishtinë, me aktvendimin PS.nr.4/22 të datës 24.06.2022, ka refuzuar si të pabazuara kërkesat për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimet e provave të parashtruara ndaj Aktakuzës PPS.nr.40/2019, të datës 04.02.2022, si dhe ndaj Aktakuzës PPS.nr.40/2019, të datës 18.02.2022, të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, nga të akuzuarit P.L., N.SH., E.B. dhe B.T., respektivisht të parashtruara nga mbrojtësit e tyre Avokatët Musa Damati, Driton Musliu, Afrim Salihu dhe Urim Vokshi. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, kjo çështje penale do të kalojë në shqyrtim gjyqësor.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë:

- Mbrojtësi i të pandehurit P.L., avokatit Musa Damati, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale dhe për shkak të mos përshtimit të veprës penale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta anuloj apo ndryshoj aktvendimin dhe të hudhë aktakuzën.
- Mbrojtësi i të pandehurit N.SH., avokat Driton Musliu, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta hedhë poshtë aktin akuzues ose çështjen ta kthejë në rivendosje për shkak të mos përshtimit të veprës penale dhe mungesës së provave që mbështesin dyshimin.
- Mbrojtësi i të pandehurit E.B., avokat Afrim Salihu, për shkak se provat nuk janë marrë në mënyrë të ligjshme, ka bazë të artikulusmë që gjykata të çmojë provën si thellësisht të pambështetëshme, nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën po akuzohet, me propozim

që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën, ta prishë vendimin dhe ta kthej në rishqyrtim ose ta ndryshoj vendimin dhe ta hudhe poshtë aktakuzën.

- Mbrojtësi i të pandehurit B.T., avokat Urim Vokshi, për shkak të shkeljes së të drejtës të cilat i garantohet të pandehurit me Kushtetutë si dhe të drejtës procedurale të të pandehurit të parapare sipas KPP, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën, ta ndryshoj aktvendimin e ankimuar të aprovohet kërkesa për hudhjen e aktakuzës dhe të pushojë procedurën penale ndaj të pandehurit.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën, PPN/I.nr.295/22, të dt.05.08.2022, ka propozuar që të refuzohen si të pa bazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve dhe aktvendimin i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti Special, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesa, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

1.Në ankesën e mbrojtësit të pandehurit N.SH., avokati Driton Musliu, thekson se gjykata e shkallës së parë duke ju referuar kundërshtimit të bërë ka dhënë pikëpamjen e saj në faqe 6,7 dhe 8, mirëpo në rastin konkret gjykata ka tejkalluar autorizimet e saj në lidhje me këtë fazë të procedurës duke i dhënë kahje determinuese aktvendimit dhe duke konstatuar gjetjet e saj, të përshkuar në dispozitivin e prokurorit të shtetit. Gjithashtu në lidhje me kodin e mirësjelljes i cili është kontestuar që gjendet në shkresat e lëndës, por nuk është kontestues se gjendet në shkresat e lëndës mirëpo kontestuese është se nuk ka asnjë relevancë pasi që ajo asnjëherë nuk i është prezantuar të pandehurit dhe të pandehurave tjerë, si dokument gjatë punës të tyre. Prandaj në përputhje me nenin 259 të Kodit të Procedurës Penale qartazi kjo provë është e pa rëndësishme apo thellësisht të pa mbështetshme, si rrjedhojë e pa pranueshme. Në anën tjetër në bazë të shkresave në dispozicion vërtetohet se Qeveria e Kosovës, saktësisht Ministria e Infrastrukturës e pranon se nuk i ka siguruar mjete financiare sipas dinamikës së paraparë. Në shkresën e datës 15 gusht 2016 me nr. protokollin 37296/16, ministri L.ZH. e njofton Komisionin Ndërmintor për mos përmbushjen e obligimeve financiare ndaj punë kryerit OE "B...", sipas klauzolës 8.4 dhe nën klauzolës 8.5 (kushtet e veçanta të kontratës) ku pikërisht mos përmbushje e obligimeve të punëdhënësit (Qeveria e Kosovës) ka shkaktuar shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

Prandaj pretendimet e bërë në këtë fazë të aktakuzës për të pandehurin tregojnë se nuk ka asnjë përgjegjësi penale siç është pretenduar. Andaj mbrojtja propozon si më lartë.

2.Në ankesën e mbrojtësit të pandehurit P.L., avokatit Musa Damati, thekson se aktvendimi i atakuar vetëm ka përshkruar aktakuzën dhe nuk ka arritur dhe ka dështuar që të përshkruaj saktë dhe në mënyrë koncize se në çfarë vendi, mënyrë, kohe dhe cilat veprime konkrete inkriminose i ka ndërmarr i pandehuri në këtë rast, prandaj me një përshkrim të tillë të dhënë në aktvendimin e gjykatës nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme të cilat do të mbështetin dyshimin e bazuar se i pandehuri dhe të tjerët të kenë kryer veprën penale për të cilën ngarkohen. Gjithashtu, duhet të theksohet se gjatë fazës së hetimeve nuk është analizuar fare ekzistimi i kronologjisë së projektit, po ashtu zgjatja e hetimeve është bërë në mënyrë të kundërligjshme dhe jo duke u bazuar në standardet profesionale të kërkuara dhe të përcaktuar nga ligjdhënësi konfrom dispozitave relevante të KPP. Në anën tjetër, i pandehuri nuk e ka bërë aprovimin për pagesën prej 53.100.000 €, por kjo pagesë është bërë në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe atë me vendimin nr. 01/50 të datës 5 qershor 2018. Ky aktvendim nuk i përmban elementet bazike të domosdoshme apo të detyrueshme të cilat duhet ti përmbajë një Aktakuzë e ligjshme, siç janë koha dhe vendi i saktë i kryerjes së veprës penale, objektin në të cilin është kryer vepra penale, mjetin me të cilën është kryer vepra penale, si dhe rrethana tjera të nevojshme për të përcaktuara veprën penale. Andaj mbrojtja propozon si më lartë.

3.Në ankesën e mbrojtësi të të pandehurit E.B., avokati Afrim Salihu thekson se të gjitha provat personale të siguruar kundër të pandehurit në aktakuzën e ngritur, janë të kundërligjshme sepse janë siguruar në bazë dhe si rrjedhojë e një aktvendimi për fillimin e hetimeve, i cili është i kundërligjshëm, për shkak të tejkalimit të afati ligjor dhe me shkelje të dispozitave të KPPK, më saktësisht kallëzimi penale ndaj të pandehurit ishte dorëzuar me datë 04.07.2019, ndërsa aktvendimi për fillimin e hetimeve ishte lëshuar me datë 07.08.2019, ndërsa sipas nenit 82, të KPPK, prokuroria duhet të nxjerr vendim për fillimin e hetimeve 30 ditë pas pranimit të kallëzimit penale. Gjithashtu, edhe ngritja e aktakuzës është bërë pas kalimit të afati prej 24 muajve, në kundërshtim me dispozitat e KPPK, sipas të cilave parashihet se hetimet do të duhej të ishin pushuar me kalimin e afat prej 24 muajve. Tutje theksohet se nuk ka asnjë provë të ligjshme për të cilën akuzohet në aktakuzë. Në anën tjetër pika II e dispozitivit të aktakuzës duhet të hudhet poshtë për shkak të arsytimit kundërthënëse, të pa mbështetura në asnjë provë dhe përfundimisht jo logjik, sepse në veprimet e të pandehurit nuk cilësohen elemente e figurës së veprës penale me të cilën ngarkohet, sepse ka munguar autorizimi i tij apo kompetenca dhe

autoritet në mënyre që të mund të konstatohej kryerja e veprës penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritet zyrtar, qoftë me veprim ose mosveprim, siç pretendohet. Gjithashtu në rastin e të pandehurit si këshilltar politik, këto kompetenca nuk kishin ekzistuar sipas rregullores nr.02/2011, prandaj i njëjti nuk ka mundu as t'i përdor këto kompetenca apo autoriteti zyrtar apo t'i keqpërdor të njëjtat. Arsyetimi i prokurorisë për të mbështetur në pikën II të aktakuzës nuk i takon figurë së veprës penale, pasi për veprën e lartcekur, nuk parashihet ndikimi, presioni, mashtrimi apo lajthitja ndaj tjetër kujt, por vetëm keq përdorimi i kompetencave apo autoritet nga personi i cili ka autorizime apo nuk i ka këto autorizime, por ndërmerr veprime në tejkalim të tyre. Dhe këto elemente nuk mund të gjenden tek i pandehuri, i cili akuzohet për këtë vepre penale. Andaj mbrojtja propozon si më lartë.

4.Në ankesën e mbrojtësi të të pandehurit B.T., avokat Urim Vokshi thekson se mungon lidhja kazuale në mes të veprimeve të pandehurit dhe pasojës së shkaktuar, në këtë çështje nuk është kontestuese se i pandehuri e ka nënshkruar marrëveshjen e datës 27 gusht 2017 për shtyrjen e afati të punimeve, mirëpo kontestuese është pretendimi i prokurorisë se me këtë veprim është shkaktuar pasoja në buxhetin e Republikës së Kosovës në lartësi prej 38,321.346€. I pandehuri nuk mund të mbahet përgjegjës për veprimet e personave tjerë, pasi që i njëjti vetëm e ka nënshkruar një dokument i cili e ka autorizuar zgjatjen e kohës së zhvillimit të punëve e që ka qenë në përputhje me opsionin e Hill. Gjithashtu, pas zgjatjes së afatit të hetimeve, më datë 14 janar 2022, është nxjerr aktvendim për zgjerim të hetimeve edhe ndaj të pandehurit, nga kjo rrjedh se në kohën e nxjerrës së aktvendimit i pandehuri ka qenë palë në procedurës, kështu që i njëjti aktvendim nuk ka krijuar pasoja juridike ndaj tij, ndërsa aktvendimi për zgjatjen e afatit të hetimit vlen vetëm ndaj personave për të cilat ka filluar hetimi dhe jo për personat e tjerë për të cilët hetimi mund të zgjerohet me vonë rrjedh edhe nga fakti se ndaj këtij aktvendimi të gjyqtarit të procedurës paraprake, palët në procedurë kanë të drejtë të ushtrojnë mjetin juridik të ankesës, kurse i pandehuri meqenëse nuk ka qenë i përfshirë si pandehur në atë kohë, një të drejtë të tillë nuk e ka pasur fare. Përveç se ky aktvendim nuk prodhon pasoja juridike theksojmë se i njëjti është nxjerrë pa u plotësuar kushtet ligjor për zgjatjen e afatit, për shkak se arsyetimi i aktvendimit për zgjatjen e afatit është në kundërshtim me gjendjen faktike dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, pasi që nuk ekzistojnë rrethana që të vazhdoj afati i hetimit. Në anën tjetër provat e nxjerra pasa se të merret aktvendimi për zgjerim të hetimi duhet të shpallen të pa pranueshme. Prandaj, aktakuza ndaj të pandehurit është e pa rregullte në aspektin procedural, si dhe është e pa bazë në aspektin material dhe kalimi i kësaj çështje penale në

shqyrtim gjyqësore, në kuptim të nenit 415, paragrafi 2. të KPRK, është e panevojshme dhe do ta dëmtonte pa arsye të pandehurin. Andaj mbrojta propozon si më lartë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara, sepse me aktvendimin për refuzimin e kërkesës për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, gjykata e shkallës së parë në aktvendimin e ankimuar i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë kërkesat e paraqitura nga mbrojtësit dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme se aktakuza e ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës PPS.nr.40/2019, të datës 04.02.2022, dëshmohet se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilët akuzohen duke u mbështetur në prova materiale, andaj nga vlerësimi i shkresave të lëndës për në këtë fazë të procedurës nuk ka asnjë rrethanë që mund të plotësojë kushtet për kundërshtimin e provave nga neni 249 par.1 të KPPRK-së, si dhe kushtet për hudhjen e aktakuzës nga neni 250 par. 1 të KPPK-së.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate në aktvendimin e kundërshtuar, Gjykata e shkallës së parë ka dhënë në mënyrë të zgjeruar arsye lidhur me dyshimin e bazuar rreth provave të kundërshtuara dhe drejt ka vërtetuar se ekzistojnë prova të mjaftueshme të pranueshme në aspektin ligjor-procedural, duke u bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se nga veprimet e përshkruara në aktakuzë, tani ekzistojnë elementet qenësore të veprës penale për të cilën janë akuzuar të akuzuarit, prandaj në këtë drejtim pretendimet ankimore janë të pa bazuara.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, në lidhje me pretendimet e avokatit Musa Damati, paraqitur në ankesë lidhur me papërcaktueshmërinë e kohës, vendit, mënyrës së kryerjes së veprës penale, apo edhe mos-përshkrimin e veprimeve inkriminuese, kjo gjykatë e gjen si të pa bazuar, sepse nga vlerësimi i aktakuzës pasqyrohet se e njëjta është hartuar konform nenin 241 par.1 pika 1.4 i KPP, prandaj në këtë fazë të kësaj procedure penale akti akuzues ka bazë ligjore për tu proceduar në fazat e tjera të procedurës penale.

Nga vlerësimi i pretendimeve ankimore të mbrojtësit të pandehurit avokatit Driton Musliu, se Statuti dhe Kodi i Sjelljes i Komitetit Drejtues Ndërministror, i datës 20.06.2012, i cili është propozuar në aktakuzë (faqe 4, prova 5.2), nuk i është prezantuar asnjëherë të pandehurit, del të jete pretendim i paqëndrueshëm, sepse me vete faktin e ushtrimit të detyrës zyrtare, dokumenti në fjalë ka qene në kuadër të fushëveprimtarisë së punës së të pandehurit, ndërsa në lidhje me

përmbajtjen dhe efektin e kësaj provë, është çështje e vlerësimit gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësorë.

Pretendimet e mbrojtësit të pandehurit, avokatit Afrim Salihu, se prokuroria ka dështuar të përmbush obligimin ligjor nga neni 132 par.6 të KPRK, kjo gjykate e gjene si të pa bazuar, ashtu siç ka vlerësuar edhe gjykata në aktvendimin e ankimuar, se në bazë të dispozitës se nenit 128 të KPP, ka paraparë shprehimisht rastet kur deklarata është e papranueshme dhe në këtë dispozitë nuk përmenden rrethanat nga neni 132 par.6 të KPP. Gjithashtu, kjo gjykate vlerëson si të pa bazuar, pretendimin e mbrojtësit se deklarata e të pandehurit e dhënë në polici në cilësi të dëshmitarit me datë 07.03.2019, të shpallet si provë e pa pranueshme, vlerësohet se i mungon ligjshmëria objektive e subjektive, për arsye se nuk është e paraqitur si provë për tu administruar e vlerësuar në fazën e shqyrtimit gjyqësore.

Pretendimet e mbrojtësve të pandehurve në lidhje me kalimin e afatshmëris së hetimeve, për kolegjin e kësaj gjykate, janë të pa bazuara, për faktin se duke marr parasysh afatet kohore të hetimit te cilat fillojnë me aktvendimin për fillimin e hetimeve dhe vazhdimin i hetimeve edhe për gjashtë (6) muaj, të gjitha veprimet e ndërmarra gjatë këtij afati janë veprime të marr konfom dispozitave nga neni 159 par 1 dhe 2 të KPPRK-së, nga kjo dispozitë kuptohet si Aktvendim për fillimin e Hetimit si dhe vazhdimin i hetimeve edhe për gjashtë (6) muaj kanë efekt të njëjtë juridik në çështjen penale.

Gjykata e Apelit, e gjen se në parim provat ndaj të pandehurve janë marrë ne mënyre të ligjshme ndërsa për besueshmërinë dhe vlerësimin e provave i takon Gjykatës së shkallës së parë që t'i vlerësoj provat në raport me të gjithë të akuzuarit dhe të vendos lidhur me administrimin e tyre në procedurën e mëtejshme gjyqësore. Pretendimet tjera të mbrojtësve kryesisht kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, çka kjo Gjykatë gjen se në këtë fazë të procedurës nuk mund të vlerësohen provat, por të njëjtat duhet të administrohen në shqyrtim të hapur gjyqësor.

Për arsyet e lartcekura, kjo Gjykatë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka refuzuar kërkesat e mbrojtëseve të të akuzuarve për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, si të pabazuara në bazë të nenit 249 par.3 të KPPRK-së, me që nuk paraqitet asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 250 par.1 nënpar.1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitës së nenit 416 par.2 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti Special
PN.S.nr.41/22, datë 22.08.2022

Bashkëpunëtori profesional

Kryetare e kolegjit

Bajram Rexhahmetaj

Afërdita Bytyçi